



Informacion dhe ndihmë për viktimat e krimit



INFORMACION PËR VIKTIMAT E KRIMIT

Informacioni i mëposhtëm është përgatitur për të dhënë përgjigje për pyetje që bëhen zakonisht nga personat që vijnë në kontakt me sistemin e drejtësisë penale si viktimë e krimit. Gjithashtu, është përfshirë informacion që do t'ju ndihmojë të kuptoni se si funksionon sistemi i drejtësisë penale.

Roli i prokurorisë në Republikën e Shqipërisë është të hetojë dhe të ndjekë penalisht në mënyrë të drejtë dhe të paanshme veprat penale. Megjithatë të drejtat e viktimës garantohehen nga prokurori, ky i fundit nuk është avokati juaj dhe nuk mund t'ju japë këshilla ligjore. Në raste të caktuara, interesat e hetimit penal mund të jenë të ndryshëm nga interesat tuaj, si viktimë.

Të drejtat e viktimave ushtrohen sipas procedurave të përcaktuara në ligj, nën autoritetin e prokurorit ose gjykatës. Ligji parashikon të drejtat e mëposhtme për viktimat e veprave penale:

TË DREJTAT E VIKTIMAVE

1. Të drejtën për të kërkuar ndjekjen penale të fajtorit.
2. Të drejtën për të përfituar kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale.
3. Të drejtën për të komunikuar në gjuhën e tyre dhe për t'u ndihmuar nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar.
4. Të drejtën për të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, për të përfituar ndihmë juridike falas sipas legjislacionit në fuqi.
5. Të drejtën për të kërkuar në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe për t'u njohur me aktet e provat, pa çenuar parimin e sekretit hetimor.
6. Të drejtën për të kërkuar marrjen e provave, si dhe për të parashtruar kërkesa të tjera përpara organit procedues.
7. Të drejtën për t'u informuar për arrestimin e të akuzuarit dhe lirin e tij, në kushtet e caktuara në Kod.
8. Të drejtën për t'u njoftuar për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjyqimit.

9. Të drejtën për të bërë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen.

10. Të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit dhe për t'u pranuar si paditës civil në procesin penal.

11. Të drejtën për t'u përjashtuar, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale.

12. Të drejtën për t'u thirrur në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore.

13. Të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar.

Përveç këtyre, viktimat e mitura (nën 18 vjeç) kanë edhe këto të drejta:

- 1) Të drejtën për t'u shoqëruar nga një person i besuar.
 - 2) Të drejtën për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale.
 - 3) Të drejtën për të kërkuar që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.
 - 4) Të drejtën për t'u trajtuar në përputhje me moshën dhe për t'u pyetur nga persona të specializuar.
- Interesin më i lartë të fëmijës është një nga parimet e procesit penal dhe organet kompetente janë të detyruar të argumentojnë se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit.

Përveç këtyre, viktimat e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë edhe këto të drejta:

- 1) Të drejtën për t'u pyetur pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini.
- 2) Të drejtën për të refuzuar t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me jetën private, të cilat qartësisht nuk kanë lidhje me veprën penale.
- 3) Të drejtën për të kërkuar të dëgjohet nëpërmjet mjeteve audio-vizive.

Prokuroria është përgjegjëse për të garantuar respektimin e të drejtave që u janë njohur viktimave. Kontakti me prokurorinë sigurohet nëpërmjet Sektorit të Ndihmës për Personat me Status të Posaçëm . Nëse dëshironi, mund të këshilloheni me një avokat në lidhje me të drejtat tuaja.

Nëse mendoni se një punonjës i policisë gjyqësore nuk ju ka lejuar të ushtroni një nga të drejtat tuaja, mund të ankoheni tek prokurori. Nëse ankesa juaj drejtohet ndaj prokurorit, mund ta paraqisni atë tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

FAZAT E ÇËSHTJES PENALE

HETIMI

Viktima ka të drejtën të informohet për ecurinë e hetimit brenda kufijve të sekretit hetimor, të kërkojë marrjen e provave dhe të bëjë kërkesa të tjera, sipas ligjit.

ARRESTI NË FLAGRANCË DHE ARRESTIMI

Arrestimi në flagrancë bëhet nëse autori kapet gjatë kryerjes së krimit ose menjëherë pasi e ka kryer atë.

Arrestimi urdhërohet nga gjykata në një seancë jo publike, në bazë të kërkesës së prokurorit.

SEANCA E VLEFTËSIMIT TË ARRESTIT / MIT

Gjykata vlerëson ligshmërinë e arrestit në flagrancë ose mënyrën e zbatimit të vendimit për arrestim. Gjykata mund të urdhërojë qëndrimin e të pandehurit në paraburgim, lirin e tij ose të caktojë një masë tjetër sigurimi.

PUSHIMI I ÇËSHTJES

Viktima ka të drejtë të ankimojë në gjykatë vendimin e prokurorit për pushimin e çështjes [për kundravajtje penale]. Viktima mund të ankimojë edhe vendimin e gjykatës për pushimin e çështjes [për krime].

URDHRI PENAL

Urdhri penal nxirret për kundërvajtje penale nga prokurori, i cili përcakton dënimin me gjobë. Urdhri penal duhet të miratohet nga gjykata. Shpërblimi i viktimës nuk është pjesë e urdhrit penal dhe ajo nuk njohet për urdhrin.

GJYKIMI ME MARRËVESHJE

Për vepra që dënohen jo më shumë se 7 vjet në maksimum, i pandehuri dhe prokurori mund të bëjnë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të përcaktojnë masën e dënimit. Marrëveshja duhet të miratohet nga gjykata dhe, nëse viktima ka paraqitur padi civile, dëmshpërblimi është pjesë e detyrueshme e saj.

SEANCA PARAPRAKE

Gjyqtari i seancës paraprake shqyrton kërkesën e prokurorit për pushimin ose dërgimin e çështjes në gjyq. Thirrja e viktimës në seancë paraprake është e detyrueshme. Viktima ka të drejtën të flasë.

GJYKIMI

Thirrja e viktimes në seancën e parë gjyqësore është e detyrueshme.

GJYKIMI NE APEL

Viktima nuk ka të drejtën e apelit. Viktima thirret në gjykimin në apel vetëm nëse padia civile është shqyrtuar.

GJYKIMI NE GJYKATËN E LARTË

Viktima nuk ka të drejtën e ankimit. Viktima thirret në Gjykatën e Lartë vetëm nëse padia civile është shqyrtuar.

DËMSHPËRBLIMI NGA I

Në bazë të ligjit, ju keni të drejtë të kërkonit shpërblimin e dëmit që keni pësuar si pasojë e krimit nga i pandehuri apo personat që përgjigjen për të (p.sh.: prindërit për fëmijën nën 18 vjeç). Shpërblimi i dëmit mund të kërkohet në gjykatën penale, gjatë gjykimit të çështjes penale, ose në mënyrë të veçantë në gjykatën civile. Padia mund të ngrihet për të kërkuar si dëmin material, ashtu edhe jo material.

Është e rëndësishme që të ruani fatura apo të dhëna lidhur me humbje të pësuar apo shpenzime të kryera, që lidhen me krimin: shpenzime mjekësore, funerale, humbja e pagës, dëmtime të pronës, etj. Është po kaq e rëndësishme që padia civile të paraqitet qysh gjatë fazës së hetimit, për t'i lejuar prokurorit që të mbledhë edhe provat që lidhen me shkaktimin e dëmit.

NDIKIMI EMOCIONAL I KRIMIT

Shumë viktima dhe dëshmitarë të krimeve ndikohen emocionalisht nga kjo përvojë. Çdo person reagon ndryshe, por shumë persona raportojnë reagime të ngjashme, si:

- * Zemërim;
- * Ndenjë paniku dhe/ose ankthi;
- * Makthe dhe ndryshim të ciklit të gjumit;
- * Ndenjë dyshimi në vetvete, turp ose faj;
- * Përjetim rishtas të asaj që ka ndodhur;
- * Depresion, vështirësi në përqendrim;
- * Shqetesim në rritje për sigurinë personale dhe të familjes.

Shumë njëzë vazhdojnë t'i kenë këto reagime edhe pasi ka kaluar kohë nga ngjarja. Ne mund t'ju ndihmojmë për të gjetur shërbimet e duhura mbështetëse dhe ndihmën e duhur për t'i kaluar këto pasoja të krimit.

“Të jesh viktimë në duart e një kriminelit është një makth që nuk harrohet. Po, më pas, të bëhesh viktimë në duart e sistemit të drejtësisë penale është një dështim i pafalshëm. I bën kriminelin dhe sistemin e drejtësisë penale partnerë në krim.”

Robert Grayson

NËSE KËRCËNOHENI

Nëse kërcënoheni apo ndiheni të pasigurt për shkak të bashkëpunimit në hetimin e kësaj çështjeje, ne mund t'ju ndihmojmë. Siguria juaj është shumë e rëndësishme për ne. Ju lutem, kontaktoni menjëherë oficerin që po heton çështjen ose prokurorin. Ata mund të diskutojnë me ju masa sigurie shtesë, si për shembull: urdhër mbrojtjeje, strehim në strehëza, kallëzime të reja penale, dhënien e dëshmisë në distancë, etj.

Nëse jeni dëshmitar, mund t'ju ofrohet edhe një sallë pritjeje të veçantë nga i pandehuri dhe dëshmitarët e tjerë, mbështetje nga personeli i gjykatës dhe informacion e asistencë për shpenzimet që lidhen me paraqitjen në gjyq.